

المختصر في صفة الحج (الجمعية)

PËRMBLEDHJE E SHKURTËR

MBI FORMËN E HAXHIT

PËRMBLEDHJE E SHKURTËR MBI FORMËN E HAXHIT

Falënderimi i takon Allahut, Zotit të botëve, paqja e bekimet qofshin për pejgamberin tonë Muhamedin, familjen dhe gjithë shokët e tij!

Sakaq...

Kjo është një përmbledhje e shkurtër rreth mënyrës së kryerjes së Haxhit, përmes së cilës jemi munduar të shpjegojmë shumicën e gjërave që i nevojiten haxhiut.

Lusim Allahun që ta bëjë këtë vepër të singertë për fytyrën e Tij fisnike dhe të dobishme për të gjithë myslimanët.

Komisioni shkencor pranë Shoqatës për Shërbimin e Mesazhit Islam në Gjuhë të Huaja

Hyrje

Së pari: kushtet e pranimit të adhurimit

Adhurimi nuk është i pranuar tek Allahu i Lartësuar vetëm se nëpërmjet dy kushteve:

Sinqeriteti (Ihlasi): që do të thotë qëllimi të jetë për kënaqësinë e Allahut dhe për botën tjetër. Allahu i Lartësuar thotë:

﴿وَمَا أُمِرُوا إِلَّا لِيَعْبُدُوا اللَّهَ مُخْلِصِينَ لَهُ الدِّينَ حُنَفَاءَ...﴾،

"E nuk ishin urdhëruar për gjë tjetër, përveçse ta adhurojnë Allahun me singeritet në fe, duke iu shmangur idhujtarisë."¹ (Bejjine: 5)

Pejgamberi, paqja qoftë mbi të!, ka thënë:

«إِنَّمَا الْأَعْمَالُ بِالنِّيَّاتِ، وَإِنَّمَا لِكُلِّ امْرِئٍ مَا نَوَى» [2].

"Veprat varen nga qëllimet dhe secilit i takon ajo që ka patur për qëllim."²

Pasimi i Pejgamberit në adhurim me fjalë dhe me vepër. Pejgamberi, paqja qoftë mbi të!, ka thënë:

«مَنْ أَحْدَثَ فِي أَمْرِنَا هَذَا مَا لَيْسَ فِيهِ فَهُوَ رَدٌّ» [3].

"Ai që shpik në fenë tonë diçka që nuk është prej saj, nuk do t'i pranohet."³ Në një transmetim tjetër të Muslimit thuhet:

«مَنْ عَمِلَ عَمَلًا لَيْسَ عَلَيْهِ أَمْرُنَا فَهُوَ رَدٌّ» [4].

"Ai që bën një vepër, që nuk mbështetet nga feja jonë, nuk do t'i pranohet."⁴

Së pari: Rregullat e Mikateve

Mikatet janë vendet (kufijtë) që i ka caktuar Profeti, paqja qoftë mbi të!, si pika nga ku duhet të hyhet në gjendjen e ihramit për këdo që synon Haxhin ose Umren.

¹ Të përkushtuar ndaj Tij dhe adhurimit të Tij, duke u larguar nga çdo gjë tjetër. (Tefsiri i Sa'dit, fq. 538)

² Transmetuan Buhariu nr. 1 dhe Muslimi nr. 1907.

³ Transmetuan Buhariu nr. 2697 dhe Muslimi nr. 1718.

⁴ Transmetoi Muslimi nr. 1718.

Kush kalon në njërin prej tyre me nijet për Haxh ose Umre, është i detyruar të hyjë në ihram nga ai vend dhe nuk i lejohej ta kalojë pa hyrë në ihram.

Ai që ndodhet më afër Mekës se mikatet, atëherë mikati i tij është vendi ku ndodhet, dhe prej andej hyn në ihram për Haxh ose Umre.

Populli i Mekës dhe ata që banojnë në të, hyjnë në ihram për Haxh nga vetë Meka, ndërsa për Umre duhet të dalin jashtë kufijve të saj, në vendet e lejuara; si p.sh. Ten'imi, dhe aty të hyjnë në ihram.

Ai që është në aeroplan, hyn në ihram kur avioni kalon paralel me mikatin. Kështu që, ai duhet të përgatitet dhe të veshë rrobat e ihramit, përpara se ta kalojë atë. E kur ta kalojë, bën nijetin menjëherë dhe nuk lejohej ta shtyjë për në aeroport. Për siguri, mund të fillojë ta shqiptojë telbijen pak para se ta kalojë mikatin, për shkak të shpejtësisë së avionit.

Së dyti: Llojet e riteve të Haxhit dhe rregullat e tyre

Llojet e riteve janë tre: Temettuë, Ifrad dhe Kiran.

Temettui është më i miri për atë që nuk ka sjellë kurban me vete. Temettui realizohet në këtë mënyrë, që njeriu të hyjë në ihram për Umre gjatë muajve të Haxhit, kryen tavafin dhe sa'jin, pastaj del nga ihrami. Më pas, po në të njëjtin vit, hyn në ihram për Haxh.

Ifradi realizohet duke hyrë në ihram vetëm për Haxh. Kur të arrijë në Mekë, është e preferuar të bëjë tavafin e ardhjes dhe sa'jin për Haxh, por nuk pret flokët dhe nuk del nga ihrami. Qëndron në ihram deri pas hedhjes së gurëve në ditën e Bajramit. Nëse e shtyn sa'jin për pas tavafit të Haxhit, është në rregull.

Kirani realizohet duke hyrë në ihram për Umre dhe Haxh së bashku, duke thënë: “Lebbejke Allahumme Umreten ue Haxhhen.”

Veprimet e atij që bën Kiran janë si ato të atij që bën Ifrad, por ai që bën Kiran ka për detyrë të therë kurban, ndërsa ai që bën Ifrad, jo.

Së treti: Mënyra e hyrjes në ihram dhe rregullat e tij

Ai që dëshiron të hyjë në ihram, rekomandohet të bëjë këto gjëra:

Larja: është sunet i fortë për burrat dhe gratë, madje edhe për gratë me menstruacione apo lehoni.

Parfumosja: Burri parfumoset me aromat më të mira si vaj udi apo të tjera, në kokë dhe mjekër. Nuk prish punë nëse aroma mbetet edhe pas hyrjes në ihram. Gruas nuk i lejohet të parfumoset me aromë që mund ta ndiejnë meshkujt e huaj.

Veshja e ihramit: Për burrat është izari dhe ridaja (dy pëlhura të bardha e të pastra). Gruaja mund të veshë çfarë të dojë nga rrobat modeste, për sa kohë nuk zbukurohet, nuk lejohet të veshë nikab

apo doreza, por duhet të mbulojë fytyrën dhe duart me diçka tjetër kur ndodhet pranë burrave të huaj.

Të hyjë në ihram pas një namazi (qoftë namaz farz apo nafile). Kjo nuk është detyrë, por e pëlqyeshme.

Pastaj bën nijetin dhe thotë:

“Lebbejke Allahumme Umreten” – nëse është për Umre,

“Lebbejke Allahumme Haxhen” – nëse është për ritin e Ifradit,

“Lebbejke Allahumme Umreten ue Haxhen” – nëse është për ritin e Kiranit.

Nëse njeriu që po futet në ihram ka frikë se mund të pengohet pa e përfunduar Haxhin, ai mund të vendosë një kusht duke thënë:

“... nëse më pengon diçka, vendi im i lirimit është aty ku pengohem.” Nëse e pengon diçka vërtet, ai del nga ihrami pa pasur ndonjë detyrim.

Pas kësaj, duhet thënë sa më shpesh Telbija:

“Lebbejke Allahumme Lebbejk, Lebbejke la sherike leke Lebbejk, inne el-hamde uen-ni’mete leke uel-mulk, la sherike lek.” Burri e thotë me zë të lartë. Poashtu dhe gruaja kur është vetëm, larg burrave të huaj. Telbija duhet të thuhet sa më shpesh sidomos kur ndryshon situata ose koha: si gjatë zbritjes, ngjitjes, kur fillon nata apo dita.¹

¹ Kuptimi i fjalëve të Telbijes:

“Lebbejke Allahumme”: do të thotë “Të përgjigjem Ty o Zot herë pas here në kryerjen e adhurimeve”.

Telbija është e pëlqyeshme të bëhet në Umre nga hyrja në ihram deri në fillim të tavafit.

Ndërsa në Haxh, nga hyrja në ihram e deri kur fillon hedhja e gurëve të Xhemretul-Akabesë ditën e Bajramit.

Muhrimi (personi në ihram) duhet të ruhet nga ndalesat e ihramit, derisa të dalë prej tij.

Së katërti: Ndalesat e ihramit

Gjërat e ndaluara gjatë ihramit janë:

Rruajtja, shkurtimi apo shkulja e qimeve nga çdo pjesë e trupit.

Prerja (plotësisht apo pjesërisht) e thonjve të duarve apo të këmbëve.

Mbulimi i kokës me diçka që e prek kokën (për meshkujt), si kapelë, shall, çallmë, rrobe, shami, batanije, karton apo diçka tjetër që përdoret për të mbuluar kokën. Ky rregull është specifik për meshkujt, jo për femrat.

Veshja e rrobave të zakonshme të qepura sipas trupit si, këmisha, pantallonat, çorapet dhe dorezat. Kjo gjithashtu është specifike për meshkujt.

“El-hamd”: pohimi i përsosmërisë për Allahun me dashuri dhe madhërim.

“En-ni’me’h”: të mirat që u jep Zoti robërve të Tij si plotësimi i kërkesave dhe largimi i së keqes.

“El-mulk”: zotërimi dhe sundimi janë vetëm për Allahun.

“La sherike lek”: askush nuk të shoqëron në cilësitë e Tua, përfshirë sundimin, krijimin, përkujdesin dhe hyjninë.

(Marrë shkurtimisht nga "Mexhmu' Fetava ue Resa'il el-Uthejmin", vëllimi 22, fq. 96.)

Ndërsa femrat ndalohen nga veshja e nikabit, perveç shallit që përngjan me nikabin. Por, mund ta mbulojnë fytyrën në prani të burrave të huaj me mbulesën e zakonshme, edhe nëse mbulesa e prek fytyrën. Nuk bën të vendosin një leckë apo diçka tjetër në kokë, për të shmangur prekjen e fytyrës, ngase një gjë e tillë nuk ka argument.

Ndalohet dhe veshja e dorezave të duarve. Por duhet t'i mbulojnë duart në prani të burrave të huaj me rroben e tyre.

Parfumosja e trupit ose e copës së ihramit.

Vrasja e gjahut të tokës ose kapja e tij edhe nëse nuk e vret.

Propozimi për martesë për vete apo për dikë tjetër.

Kryerja e aktit martesor.

Prekja apo puthja me dëshirë seksuale.

Marrëdhëniet seksuale.

Së pesti: Mënyra e kryerjes së Tavafit

Kur muhrimi hyn në xhaminë e shenjtë (Qabe), është e rekomanduar të hyjë me këmbën e djathtë dhe të thotë lutjen e hyrjes në xhami. Versioni më i saktë i lutjes që përcillet në këtë situatë është: “O Allah, m'i hap dyert e mëshirës Tënde.” Kjo lutje thuhet kur hyn në çdo xhami, jo vetëm në Qabe.

Kur të fillojë tavafin, ai bën idtibanë (zhveshjen rituale të supit të djathtë). Forma e idhtibasë është:

ta vendosë mesin e pëlhurës së sipërme nën sqetullën e djathtë dhe dy cepat e saj mbi shpatullën e majtë. Pasi ta përfundojë tavafin, e kthen përsëri pëlhurën në gjendjen e mëparshme, sepse idtibaja bëhet vetëm në tavaf.

Pastaj afrohet te Guri i Zi, e prek me dorën e djathtë dhe e puth. Nëse nuk ka mundësi ta puthë, e prek me dorë dhe pastaj e puth dorën. Nëse nuk mund ta prekë as me dorë, e prek me ndonjë mjet që mund ta ketë me vete si shkop apo diçka tjetër dhe e puth atë. E nëse nuk ka mundësi ta prekë ashtu, atëherë kthehet me fytyrë nga Guri i Zi dhe bën shenjë drejt tij me dorë pa e puthur dorën. Është më mirë të mos shtyhet me të tjerët për të prekur Gurin e Zi, që të mos i lëndojë të tjerët dhe të mos lëndohet vetë.

Kur e prek Gurin apo kur i bën shenjë thotë: “Allahu Ekber!” (Allahu është më i Madhi!).

Pastaj merr djathtas, duke e pasur Qabenë në anën e majtë. Kur arrin te këndi jugperëndimor (el-Rukn el-Jemani), e prek atë pa e puthur. Nëse nuk mund ta prekë, nuk duhet të shtyhet dhe nuk i bën shenjë me dorë.

Ndërmjet këndit jugperëndimor dhe Gurit të Zi, thotë: “Zoti ynë, na jep të mira në këtë botë dhe të mira në botën tjetër, dhe na ruaj nga dënimi i Zjarrit.”

Çdo herë që kalon pranë Gurit të Zi, i bën shenjë me dorë dhe thotë: “Allahu Ekber.”

Gjatë pjesës tjetër të tavafit, lejohet të bëjë çfarëdo dhikri, lutje apo të lexojë Kuran.

Sipas Sunetit, në tri xhirot e para të tavafit ecet shpejt me hapa të shkurtër (raml). Në katër xhirot e tjera ecet normalisht.

Pasi e përfundon tavafin, afrohet te vendi i Ibrahimit (Mekami i Ibrahimit) dhe lexon: “Dhe merreni vendin e Ibrahimit si vend faljeje.” Pastaj fal dy rekate pas tij nëse ka mundësi, përndryshe në çdo vend të xhamisë. Në rekatin e parë, pas Fatihasë, lexon suren “Kul Ja ejjuhel Kafirun,” dhe në të dytin suren “Kul Huvallahu Ehad.”

﴿...وَاتَّخِذُوا مِنْ مَّقَامِ إِبْرَاهِيمَ مُصَلًّى...﴾

(Dhe falni namaz tek vendqëndrimi i Ibrahimit.)
(Bekareh: 125) Mandej le të falë dy rekate prapa mekemit të Ibrahimit, nëse mundet, përndryshe le t'i falë në çfarëdo vendi tjetër të xhamisë. Në rekatin e parë pas sures Fatiha këndon kaptinën:

﴿قُلْ يَا أَيُّهَا الْكَافِرُونَ﴾

(Kul Ja ejjuhel Kafirun) (El-Kafirun:1) Ndërsa në rekatin e dytë pas Fatihasë këndon kaptinën:

﴿قُلْ هُوَ اللَّهُ أَحَدٌ﴾

(Kul Huvallahu Ehad) (El-Ihlas:1)

Së gjashti: Mënyra e kryerjes së Sa'jit (vrapimit mes Safasë dhe Mervasë)

Pasi përfundon tavafin dhe dy rekatet, del për në vendin e Sa'jit. Kur afrohet te kodra e Safasë, lexon:

“Vërtet, Safaja dhe Mervaja janë shenja të Allahut.”
Pastaj thotë: “Filloj me atë që ka përmendur Allahu së pari.”

﴿إِنَّ الصَّفَا وَالْمَرْوَةَ مِنْ شَعَائِرِ اللَّهِ...﴾

(Me të vërtetë Safaja dhe Mervaja janë prej simboleve të Allahut) Më pas le të thotë:

«أَبْدَأُ بِمَا بَدَأَ اللَّهُ بِهِ» [6].

"E nis me atë që e nisi Allahu." (6)¹

Pastaj ngjitet në Safa, derisa ta shohë Qaben ose drejtimin e saj, kthehet me fytyrë nga ajo dhe e madhëron Allahun, duke thënë: “Nuk ka Zot tjetër përveç Allahut, Një dhe i Pashoq, Atij i përket sundimi dhe falënderimi, dhe Ai është i fuqishëm mbi çdo gjë. Nuk ka Zot tjetër përveç Allahut, Ai e përmbushi premtimin, ndihmoi robin e Tij dhe i mposhti vetë aleatët.” E përsërit këtë tri herë, duke bërë lutje mes tyre.

«لَا إِلَهَ إِلَّا اللَّهُ وَحْدَهُ لَا شَرِيكَ لَهُ، لَهُ الْمُلْكُ وَلَهُ الْحَمْدُ، وَهُوَ عَلَى كُلِّ شَيْءٍ قَدِيرٌ، لَا إِلَهَ إِلَّا اللَّهُ وَحْدَهُ، أَنْجَزَ وَعْدَهُ، وَنَصَرَ عَبْدَهُ، وَهَرَمَ الْأَحْزَابَ وَحْدَهُ»، ثُمَّ دَعَا بَيْنَ ذَلِكَ. قَالَ مِثْلَ هَذَا ثَلَاثَ مَرَّاتٍ [7].

"La ilahe il-lellahu uahdehu la sherike leh, lehul mulku ue lehul hamdu ue huve ala kul-li shej'in kadir. La ilahe il-lellahu uahdeh, enxheze ua'deh, ue nesara abdeh, ue hezemel ahzabe uahdeh." Ndërmjet kësaj ai u lut dhe e përsëriti këtë tri herë.²

¹ Transmetoi Muslimi nr. 1218.

² Transmetoi Muslimi nr. 1218.

Pastaj zbret nga Safaja për te Mervaja duke ecur. Kur arrin te shenjat e gjelbra (dy shtyllat e gjelbra), ecën me nxitim (hapa të shpejtë). Kur kalon shtyllën e dytë, e ul shpejtësinë dhe ecën normalisht. Për gratë nuk është e rekomanduar ecja e shpejtë.

Kur arrin në Merva, është e pëlqyeshme të bëjë njësoj si në Safa (shih pika 2).

Pastaj kthehet nga Merva për në Safa duke ecur, dhe te shenja e parë e gjelbër vrapon me hapa të shpejtë, ndërsa te shenja e dytë e gjelbër e ngadëlëson vrapin dhe ecën normalisht.

Kështu vazhdon, derisa të plotësojë shtatë xhirot. Shkuarja nga Safa në Merva është një xhiro, dhe kthimi nga Merva në Safa është një tjetër.

Gjatë Sa'jit mund të bëjë dhikër, lutje dhe të lexojë Kuranin sipas dëshirës.

Së shtati: Mënyra e qethjes (rruarjes) apo shkurtimit të flokëve

Kur umrexhiu përfundon tavafin dhe sa'jin, atij i bëhet obligim të rruajë apo të shkurtojë flokët, nëse është mashkull. Suneti është që rruarja apo shkurtimi të përfshijë gjithë kokën.

Rruarja është më e pëlqyer se shkurtimi, përveç nëse koha e Haxhit është afër dhe nuk ka kohë që flokët të rriten sërish, atëherë shkurtimi është më i mirë.

Ndërsa gruaja i shkurtton vetëm pak majat e flokëve, sa mollëzat e gishtave.

Ai që është në ihram për Haxh (si Haxhi i Ifradit apo me Umren bashkë si ai i Kiranit), nuk duhet t'i presë flokët deri ditën e Bajramit pas hedhjes së gurëve në Xhemret el-Akabeh.

Me këtë, umrexhiu e ka përfunduar Umren, dhe njësoj edhe ai që kryen Haxhin Temettuë e ka kryer pjesën e Umres.

Mënyra e kryerjes së Haxhit

Së pari: Veshja e ihramit për Haxh

Është Sunet për atë që dëshiron të kryejë Haxhin që të veshë ihramin paraditen e ditës së “Teurijes” (dita e tetë e dhul-hixhxhes), nga vendi ku është nisur për Haxh nëse është në Mekë ose brenda kufijve të mikateve. E nëse është jashtë mikateve, e vesh ihramin nga mikati që kalon.

Ai vepron gjatë veshjes së ihramit për Haxh, ashtu siç ka vepruar për Umre: larje, parfumosje, falje namazi. Pastaj shpreh nijetin për Haxh dhe fillon të thotë telbijen. Forma e telbijes është si ajo e Umres, por këtu thotë: “Lebbejke Haxhen” në vend të “Lebbejke Umreten”.

Nëse ka frikë se mund ta pengojë diçka për të përfunduar Haxhin, i lejohet të vendosë kusht gjatë ihramit duke thënë: “...dhe nëse më ndalon ndonjë pengesë, atëherë vendi i liritim tim është aty ku më ndalon ajo.” Nëse i shfaqet pengesa, ai mund të lirohet nga ihrami dhe nuk ka asnjë detyrim.

Pastaj e thotë sa më shumë telbijen:

“Lebbejke Allahume lebbejke, lebbejke la sherike leke lebbejke. Innel-hamde uen-ni’mete leke uel-mulk, la sherike lek.”

Burri e thotë me zë të lartë, gjithashtu dhe gruaja, kur nuk gjendet pranë burrave të huaj. Është e këshillueshme që telbija të përsëritet shpesh, sidomos kur ndryshojnë rrethanat si; zbritja apo ngjitja në vende të ndryshme, ardhja e ditës ose natës.

Telbija vazhdon që nga ihrami deri kur fillon hedhja e gurëve në Xhemretul-Akabe ditën e Kurban Bajramit.

Ihrammbajtësi (muhrimi) duhet të ruhet nga veprimet e ndaluara në ihram, derisa të dalë prej tij.

Së dyti: Qëndrimi në Mina

Është Sunet të shkohet në Mina ditën e tetë dhe të falen atje namazet: drekë, ikindi, aksham, jaci dhe sabah, të gjitha me shkurtim, por pa i bashkuar mes vete, sepse kështu ka vepruar Profeti (paqja qoftë mbi të!).

Së treti: Qëndrimi në Arafat dhe kalimi i natës në Muzdelife

Kur lind dielli në ditën e nëntë (Dita e Arafatit), niset nga Minaja në drejtim të Arafatit dhe qëndron në Nemira, deri në mesditë nëse është e mundur; nëse jo nuk ka problem, sepse qëndrimi në të është thjesht Sunet.

Pasi të kalojë mesdita, falet dreka dhe ikindia nga dy rekate të bashkuara në kohën e drekës, siç bëri Profeti, paqja qoftë mbi të!

Pas kësaj i përkushtohet lutjeve, përkujtimit të Allahut, dhe përgjërimit, duke u lutur kah Kibla. Mund të bëjë çfarëdo lutjesh që i pëlqejnë.

Lutja më e shpeshtë e Profetit (paqja qoftë mbi të!) në këtë vend ishte:

“La ilahe il-lAllah, uahdehu la sherike leh, lehul-mulku ue lehul-hamdu, ue huve ala kul-li shej’in kadir.”

Nëse lodhet, mund të bisedojë me shokët për gjëra të dobishme ose të lexojë libra, sidomos ato që lidhen me bujarinë dhe mirësitë e mëdha të Allahut të Lartësuar. Në mënyrë që t'i shtohet shpresa atë ditë në mëshirën dhe bujarinë e Allahut të Lartësuar. Pastaj të vazhdojë sërish me lutje, veçanërisht në fund të ditës, pasi më e mira e lutjeve është ajo e Ditës së Arafatit.

Kur perëndon dielli i ditës së Arafatit, niset për në Muzdelife.

Kur mbërrin aty, falet akshami me tre rekate dhe jacia me dy rekate të bashkuara.

Nëse frikësohet se do të mbërrijë në Muzdelife pas mesnatës, atëherë i fal para se të arrijë. Por nuk bën që ta vonojë namazin deri pas mesnate.

Në Muzdelife kalon natën, e në mëngjes sapo të agojë fal sabahun herët me ezan dhe ikamet.

Pastaj shkon te Mesh'aril-Haram (një vend në Muzdelife rrugës për në Mina), e njëson dhe e madhëron Allahun dhe i bën lutjet që dëshiron, derisa të zbardhë mirë dita. Nëse nuk mund të shkojë atje, lutet aty ku është, sepse Profeti (paqja qoftë mbi të!) ka thënë: "Qëndrova këtu, por e tërë Muzdelifeja është vendqëndrim."

Gjatë dhikrit dhe lutjes i drejtohet kiblës dhe i ngre duart.

«وَقَفْتُ هَاهُنَا وَجَمَعْتُ كُلَّهَا مَوْقِفٌ» [8],

"Unë qëndrova këtu e megjithatë e gjithë Muzdelifeja është vendqëndrim." (8) Gjatë dhikrit dhe lutjes drejtohet me fytyrë nga kibla me duar të ngritura.

Së katërti: Veprimet në ditën e Bajramit

Kur zbardh mirë dita, niset nga Muzdelife drejt Minasë, para lindjes së diellit. Kur të kalojë nëpër luginën e Muhassirit i shpejton hapat.

Kur arrin në Mina, hedh shtatë guraleca në Xhemretul-Akabe, e cila është është e fundit nga krahu i Mekës. Guralecat i hedh një e nga një. Madhësia e tyre duhet të jetë sa madhësia e një bërthame hurme, dhe thotë "Allahu Ekber!" me çdo guralec.

Pastaj ther kurbanin e tij, nëse ka mundësi.

Më pas rruan flokët e kokës ose i shkurton, nëse është burrë. Rruajtja është më e mirë. Ndërsa gratë

nuk lejohet të rruhen, ato shkurtojnë vetëm një pjesë të vogël të flokëve.

Pas hedhjes së guralecëve dhe rruajtjes, muhrimi lirohet nga ndalesat e ihramit dhe i lejohet gjithçka, përveç marrëdhënieve bashkëshortore.

Pastaj zbret në Mekë dhe bën tavafin e Ifades dhe më pas bën sa'jin, nëse është duke bërë Haxhin e Temettuit ose nëse është duke bërë Haxhin e Kiranit apo Ifradit dhe nuk e ka bërë më parë sa'jin pas tavafit të mbërritjes. Lejohet ta shtyjë tavafin dhe sa'jin, deri kur të vijë nata apo deri në ditën tjetër, sipas mundësisë së tij.

E pesta: Veprimet në ditët e Teshrikut

Pasi të ketë përfunduar hedhjen e guralecëve, rruajtjen, tavafin dhe sa'jin, lirohet plotësisht nga ndalesat e ihramit dhe i lejohet gjithçka, përfshirë gratë.

Kthehet në Mina dhe fle atje netët e ditës së 11-të, 12-të dhe 13-të, nëse nuk largohet më herët.

Në të trija Xhemeratet i hedh guralecat pas mesditës.

Ditën e 11-të, hedh fillimisht shtatë guralecat në Xhemren e Parë, e cila është më e largëta nga Meka dhe më afërta nga xhamia e Hajfit. I hedh një e nga një duke thënë “Allahu Ekber” në çdo hedhje. Pastaj qëndron dhe lutet gjatë për çfarë të dëshirojë. E nëse lodhet dhe nuk e përballon qëndrimin e gjatë,

atëherë të bëjë lutje të shkurtra, por të mos kalojë pa u lutur në mënyrë që të zbatohet Suneti.

Pastaj hedh guralecat në Xhemren e Mesme dhe lutet pas saj.

Pastaj hedh guralecat në Xhemren e Akabesë dhe largohet pa lutje.

Ditën e 12-të, bën njësoj si në ditën e 11-të. Pas kësaj, nëse dëshiron, mund të largohet nga Minaja pas hedhjes së guralecave.

E nëse dëshiron mund të qëndrojë dhe të kalojë edhe natën e 13-të në Mina dhe të nesërmen hedh guralecët pas mesditës njësoj si në ditët e tjera. Qëndrimi në Mina natën e 13-të është më i preferuar se largimi.

Nuk është i detyrueshëm qëndrimi në Mina deri në ditën e 13-të, por nëse Dielli perëndon në ditën e 12-të, ndërsa është ende në Mina, duhet të qëndrojë dhe të hedhë guralecët ditën tjetër pas mesdite.

Por nëse është nisur të largohet nga Minaja para perëndimit të diellit dhe është vonuar për shkak të trafikut, nuk e ka për detyrë të rrijë, sepse nuk quhet vonesë me dëshirë.

Së gjashti: Tavafi i Lamtumurës

Kur dëshiron të largohet nga Meka, për në vendlindjen e tij, nuk largohet pa bërë Tavafin e Lamtumurës.

Përveç gruas me menstruacione ose lehonë – ato nuk e bëjnë Tavafin e Lamtumirës dhe nuk është e nevojshme të qëndrojnë te porta e Qabes për t'u përshëndetur, sepse nuk transmetohet nga Profeti (paqja qoftë mbi të!) një gjë e tillë.

Tavafi i lamtumirës duhet të jetë veprimi i fundit në Qabe, para udhëtimit.

Nëse pas Tavafit të Lamtumirës vonohet për të pritur shokët, për të ngarkuar bagazhet ose për të blerë diçka, nuk ka problem dhe nuk e ka për detyrë ta përsërisë Tavafin e Lamtumirës. Por, nëse e bën Tavafin e Lamtumirës dhe më pas ndryshon qëllimisht kohën e udhëtimit, duke e kthyer nga fillimi i ditës në fund të ditës, atëherë duhet ta përsërisë Tavafin e Lamtumirës, që të jetë tavafi në Qabe gjëja e fundit që ai bën.

Përmbajtja

PËRMBLEDHJE E SHKURTËR MBI FORMËN E HAXHIT	2
Hyrje	2
Së pari: kushtet e pranimit të adhurimit	2
Së pari: Rregullat e Mikateve	3
Së dyti: Llojet e riteve të Haxhit dhe rregullat e tyre	4
Së treti: Mënyra e hyrjes në ihram dhe rregullat e tij	5
Së katërti: Ndalesat e ihramit	7
Së pesti: Mënyra e kryerjes së Tavafit	8
Së gjashti: Mënyra e kryerjes së Sa'jit (vrapimit mes Safasë dhe Mervasë).....	10
Mënyra e kryerjes së Haxhit.....	13
Së pari: Veshja e ihramit për Haxh	13
Së dyti: Qëndrimi në Mina	14
Së treti: Qëndrimi në Arafat dhe kalimi i natës në Muzdelife	14
Së katërti: Veprimet në ditën e Bajramit	16
E pesta: Veprimet në ditët e Teshrikut.....	17
Së gjashti: Tavafi i Lamtumirës.....	18